# KRIMI,POLITIKA DHE HAKMARRJA E TYRE

Nga Xhavit Shala

Disa ditë pasi në krye të Ministrisë së Rendit vjen Stefan Çipa, më datë 8 Prill 2002, më thërret në zyrën e tij. Pasi vlerësoi punën time me nota maksimale dhe tone emocionale, më komunikoi largimin nga drejtimi i policisë fierake dhe më premtoi emërimin në një detyrë të rëndësishme në Tiranë.

Por, brenda një jave, po me urdhër te ministrit, u shkarkua dhe zëvendësdrejtori, i cili ishte dhe shefi i policisë kriminale të qarkut dhe shefi i zyrës rajonale të luftës kundër trafiqeve si dhe i gjithë stafi që më kishte mbështetur dhe që ishte angazhuar në zbatim të strategjive antikrim, sidomos në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore. U mbyll menjëherë Qendra për Pritjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikut ne Fier dhe u kthye në një magazinë mallrash.

Një trafikant i fuqishëm droge, i liruar nga gjykata, por i shpallur sërish si person i shumëkërkuar, i lidhur ngushtë me një drejtues kryesorë të partisë në pushtet, filloi të qarkullojë lirshëm nëpër Fier, në shoqërinë edhe të drejtuesve të rinj të policisë. Kuptohej menjëherë që situata në qarkun e Fierit që, për rastësi, ishte dhe vendlindja e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, ishte përmbysur.

Krimi i lidhur me shumë fije të dukshme ose jo me politikën, kishte filluar hakmarrjen e tij. Diku kisha lexuar që hakmarrja është tipar i shpirtrave të vegjël që nuk e durojnë dot drejtësinë. E po ndodhte pikërisht kështu, pasi në këtë qark prej kohësh po zbatoheshin katër strategji të suksesshme, qëllimi i të cilave ishte heqja e këtij rajoni nga harta e krimit.

Njëra dhe më e rëndësishmja ishte strategjia "Për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore e sidomos të femrave me qëllim ushtrim prostitucioni". Kjo bëri që të vihen para drejtësisë, për një periudhe të shkurtër, më shumë se 150 tutorë dhe drejtues të rrjeteve kriminale të trafikut të qenieve njerëzore, pjesa më e madhe e të cilëve në gjendje arresti. Ndër to kishte persona me mbështetje në politikë

Tjetër strategji ishte ajo për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike. Si pasojë e zbatimit të saj, u reduktua kultivimi i tyre në qarkun e Fierit rreth 60 herë. Përfundimisht, ai territor u fshi nga harta e kultivimit masiv të bimëve narkotike. U penalizuan shumë trafikantë, por edhe kultivues të bimëve narkotike, disa prej të cilëve me lidhje të forta politike.

Përpjekjet për të mbyllur plagën e hapur në vitin 1997, u manifestuan në zbatimin e strategjisë për grumbullimin e dorëzimin vullnetar të armëve dhe municioneve të rëna në duart e popullsisë. Kjo bëri të mundur që të mblidhet

një numër i konsiderueshëm armësh, më shumë se ato të vjedhura në depot e qarkut të Fierit. Suksesi i arritur, jo vetëm ktheu besimin e komunitetit tek policia, por dhe përmirësoi ndjeshëm parametrat e rendit e të sigurisë ne Qarkun e Fierit.

Strategjia "Për zbulimin dhe dokumentimin e ngjarjeve te rënda kriminale të mbetura pa autor" bëri të mundur të zbulohen disa vrasje e krime te tjera, të mbuluara nga hiri i kohës si dhe të arrestohen autorët e tyre.

Vetë Ministri i Rendit Publik, Ilir Gjoni, i cili mori pjesë pothuajse në të gjitha konferencat shkencore të organizuara për promovimin e këtyre strategjive, e quajti Drejtorinë e Policisë të Qarkut Fier nismëtare e shumë veprimtarive në shkallë vendi dhe një shkollë për policinë shqiptare. Sipas tij, Drejtori i Policisë së Fierit Xhavit Shala, i ka dhënë një tjetër imazh luftës kundër krimit dhe llojeve të ndryshme të trafiqeve në këtë rajon.

Pas gjithë këtyre arritjeve, natyrshëm, që pritej një vlerësim për punën e efektivave të Policisë së Qarkut Fier, stafit drejtues, por edhe për mua si nismëtar, hartues dhe drejtues për zbatimin e këtyre strategjive antikrim.

Dhe "vlerësimi" erdhi! Një staf i tërë, pothuaj i hedhur në rrugë, në pritje të një emërimi "të rëndësishëm" sipas fjalëve të ministrit.

Ndërsa për mua, tashmë, mesazhi ishte i qartë. Krimi i lidhur me politikën, po hakmerrej për goditjet e dhëna me strategjitë antitrafik.

Intuita e profesionistit më bënte të kuptoja që për mua po vinin kohë të këqija. Me statusin e një koloneli në pritje të emërimit, tashmë duhet të mendoja seriozisht për sigurinë fizike të familjes dhe timen personale.

Nuk më mbetet tjetër veç të shpresoj që ky dispozicion të mos jetë si ai i major Ilir Ngresit, të cilin e vranë duke qenë në pritje të një emërimi.

Nga ana tjetër opinioni, media dhe komisioni i sigurisë pranë parlamentit shqiptar kanë ngritur shqetësimin për rikthimin e mafies në Policinë e Shtetit, nisur dhe nga emërimet që po bën truproja e kryeministrit Majko.

Të presim!

Tiranë maj 2002

**Gazeta Shqiptare, 27.04.2002**

# Shala: Uroj që dispozicioni jonë të mos jetë si ai i Ngresit

Kolonel Xhavit Shala ish-drejtor i Policisë Kriminale për rreth 2 vjet dhe së fundi në krye të bluve të Fierit, ka më shumë se 2 javë që është shkarkuar nga detyra dhe vërtitet rrugëve "në dispozicion". Ashtu si gjithë kolegët e tij kolonelë dhe drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, është thirrur nga ministri "as tremujor", Stefan Çipa, është falenderuar për punën e tij të mirë dhe i është komunikuar urdhëri i shkarkimit deri në emërimin në një detyrë tjetër të rëndësishme. Duket si ironi, por në fakt është një fakt i vërtetë. Të gjithë të "hedhurit në rrugë" (janë pothuajse ata që plotësojnë kriterei sipas ligjit për Policinë e Shtetit), zëvendësohen nga "çuna" të mirë dhe me prapavijë të fortë politike por... Vetë kolonel Shala i pyetur dje nga "Gazeta Shqiptare" për faktin që vazhdojnë të mos e emërojnë në asnjë detyrë tjetër pas kaq kohësh thotë: "Nuk dua të bëj komente, por gjithsesi nuk është ligjore. Në takimin e fundit që kam patur me ministrin e Rendit, Stefan Çipa, ai më ka premtuar se do të më japë përgjigje menjëherë sapo të kthehet nga Vjena. (Redaksia i kujton Çipës dhe Shalës se ministri i Rendit, ka më shumë se 1 javë që është kthyer nga Vjena).



Xhavit Shala

Unë po e pres... Gjithsesi shpresoj që kjo periudhë dispozicioni të mos jetë si ajo e Ilir Ngrehsit" (periudhë kur Ngresi u ekzekutua nga Lul Caka).

korrieri

# Skandal me emërimet në polic

## "The Boy" dhe "Tao Tao"

Kryeministri Majko dhe Ministri i Rendit Stefan Çipa, shkelin Ligjin "Për Policinë e Shtetit" në emërimin e dhjetra drejtorëve dhe shefave të komisariateve. Lista me emrat dhe të gjithë miqtë e ministrit nga Saranda, Delvina dhe Gjirokastra. Pandeli Taçi, ose njeriu që bën ligjin. Kush janë kolonelët që janë larguar me motivacionin: "Ke punuar mirë, por ... shkarkohesh"

Speciale 6,7



**KKRT**
Kryetari Sefedin Ç
shkel ligjin TV Kla
TVA e hedhin në g

**OPOZITA**
Berisha hedh në g
Pollon për demen
partisë. Denoncin

**SHKRESA**
Firma gjermane: N
sjellim drita në
Shqipëri. Skandal

**FIER**
Erion Hasanbellu
kapet atentatori i
Kasandër Nogës

SPECIALE

# "Ke punuar mirë, ... por shkarkohesh"

Misteret e shkarkimit të paargumentuar nga detyra të drejtuesve të lartë. Shkaku i vërtetë pse duhet të largoheshin dhe dalja në skenë e mbijetesa e njerëzve, që më shumë mbështeten te miq të fortë, sesa në rezultatet e një pune të mirë

Ferdinand DERVISHI

"Ke punuar shumë mirë. Do të çojmë në një detyrë më të lartë...", kishte qenë premtimi i ministrit të ri për ish-Drejtorin e Policisë së Fierit, Xhavit Shala dhe jo vetëm për të. Pas më shumë se dy javësh, Kolonel Shala dhe të tjerë drejtorë të drejtorive masin të papunë rrugët e Tiranës. Askush nuk është kujtuar t'i kthejë në radhët e policisë edhe pse vetë ministri u kishte premtuar për riemërim të shpejtë. Në të njëjtën kohë edhe Drejtori i Përgjithshëm, që i ka njohur edhe më parë në punën e tyre, hesht. Por Shala nuk është i vetmi i larguar, që sipas ministrit, kishte punuar mirë. Një tjetër rast i pakuptueshëm largimi kishte qenë ai i ish-Drejtorit të Policisë së Dibrës, Kolonel Gjon Sulit, të konsideruar nga specialistët më të aftë. Më tej edhe largimi i ish-Drejtorit të Durrësit, Arben Ruci, personazh i papërfolur gjëkundi, atij të Elbasanit Milto Kordha, një oficer që ka punuar për 25 vjet në polici, atij të Lezhës, Ilir Zaçe, që gjithashtu ka një karrierë të gjatë në polici



Ministri i Rendit Stefan Çipa

**Kolonelët e shkarkuar**

1- Bashkim Mustafa, Ish-Drejtor i Kufirit
2- Gëzim Liçi, Ish-Drejtor i Qarkullimit Rrugor
3- Milto Kordha, Ish-Drejtor i Qarkut të Elbasanit
4- Xhavit Shala, Ish-Drejtor i Qarkut të Fierit

## LIGJI DHE MALIQI

Nga Alfred PEZA

Tre vjet më parë, kur ende nuk kishte dalë në skenë fenomeni "Poçi" për shpartallimin e bandave të 1997-ës, botova në revistën "Klan" shkrimin: "Rendin e vendosim ne". Një anketë e zgjeruar për situatën e paqëndrueshme të rendit publik, e anonçuar në kopertinën ku pozonin katër Drejtorë dhe Komisarë policie. Ata rrëfenin eksperiencën se si kishin arritur të "bënin zap" krimin, apo pse kishin dështuar në këtë aventurë. Një listë e përbërë nga Drejtori i Policisë së Tiranës, Mithat Havari, Drejtori i Policisë së Elbasanit, Edmond Koseni, ish shefi i Komisariateve në Sarandë dhe Rinas, Ardian Resuli dhe shefi i Komisariatit të Policisë së Tropojës, Fatmir Meta.

Mithat Havari pasi mbeti pa punë, u emërua Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Ndërtimore, për tu shkarkuar pas zgjedhjeve të 24 qershorit 2001 dhe për të qenë sërish i papunë. Koseni ndodhet në arrest shtëpie, në pritje të procesit në Gjykatën e Faktit të Tiranës, nën akuzën e "lënies për shkak të detyrës" të dy prokurorëve, pas shkarkimit dhe arrestimit nën akuzën e "torturës" ndaj një qytetari. Në atë kohë Resuli ndodhej në dispozicion të ministrisë së Rendit dhe më pas u tërhoq në jetën private. Ndërsa i fundit i "katër mosketjerëve", Fatmir Meta, pret vendimin e Gjykatës së Tiranës, pas kërkesës së Prokurorisë për dënimin e tij me 20 vjet heqje lirie, nën akuzën e "implikimit në vrasjen e Azem Hajdarit."

Ky është fundi në detyrë i disa prej njerëzve, që kanë drejtuar në këto 11 vjet policinë shqiptare, ndërkohë që shumë ish Komisarë dhe Drejtorë të tjerë policie nëpër qytete e prefektura, janë të papunë, janë bërë biznesmenë, apo presin në dispozicion. Ndonjë prej tyre, si Komisar Ilir Ngresi u ekzekutua nga kriminelët, që kishte luftuar, ndërsa priste emërimin, ndërsa Drejtori i Shkodrës ...

korrieri

# "Mafia instalohet në polici"

**SPARTAK POÇI**, ish-Ministri i Rendit kryqëzon në Komisionin Parlamentar për Rendin dhe SHIK-un, ministrin aktual Stefan Çipa: "Në krye të drejtorive dhe komisariateve të policisë, persona me dosje dhe të lidhur me krimin. Ndryshimet, me ndërmjetësinë e trupojave të Majkos". Të gjitha lëvizjet e kritikuara dhe pse Drejtori i Përgjithshëm i Policisë është lënë jashtë emërimeve

Koabitacioni dhe "konsensusi" presidencial



**LETRA**
Baton Haxhiu: Miku im Majko, rruga që ke zgjedhur është gabim

**BISEDAT**
Ambasadorët e SHBA Britanisë e Francës në zyrën e Ilir Metës

**HOMAZH**
Lamtumira për ish-Kryetarin e PSDKJ, Vasil Melo. Ceremonia

**RREFIMI**
Elisa 18 vjeçare: Si ma vranë të dashurin pas puthjes në lokal

**GREQI**

POLITIKE

# "Mafia, në Ministrinë e Rendit"

Debate të ashpra në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për rendin dhe SHIK. Deputetët kryqëzojnë Ministrin e Rendit Stefan Çipa. Ish-ministri Spartak Poçi: "Në krye të drejtorive të policive, persona me dosje, të larguar më parë nga detyra si të dyshuar për lidhje me krimin. Emërimet bëhen nga trupojat e Majkos"



## Çipa-Klosi-Sollaku, bashkë për emërimet

RD AKTUALITET E MERKURE 15 MAJ 2002 5

Ministri Çipa braktis mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Rendit e SHIK-ut

# Majko emëron të inkriminuarit në krye të policisë

## Drejtuesit e policive në Qarqet, Shkodër, Durrës, Fier, etj., të emëruar nga Majko nuk plotësojnë asnjë kriter e kusht ligjor për këto pozicione që ata mbajnë

*"Një numër personash që janë emëruar në detyra të larta në polici, kanë qenë të larguar prej saj të akuzuar për implikime në krimin e organizuar, disa prej tyre janë në ndjekje nga organet e drejtësisë"*



Boçi: Në polici po instalohet mafia

Memia: Emërimet i bën ministri, jo Kryeministri

---

Lista e emërimeve të fundit të bëra në polici nga Pandeli Majko

# JA DOSJET E "KOLONELËVE" TË STEFAN ÇIPËS

Një pjesë e tyre janë persona të implikuar në trafiqe, të njohur për qëndrime politike gjatë karrierës së tyre, si edhe një pozicion të sigurimit të shtetit



Pjerin Ndreu kërkon përforcime nga Tirana. Dje forca të reja në Bajram Curri

## Kur Meta brenda një dite takon tre ambasadorë...

**Nga Blegina Agolli**

## Bodigardi i Majkos, Eldoni, bën emërimet në polici

## Familjarët e Majkos dhe Islamit, prapa formulës së privatizimit të INSIG-ut